



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1379\_09\_15**;
- Ankesa e KESCO-s e datës **06.10.2015**;

**në seancën e mbajtur më datë 28 janar 2015, nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHET** ankesa e KESCO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin K.E. me shifër DPR - 16683 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1379\_09\_15** i datës 17.09.2015.

**A r s y e t i m**

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 06.10.2015 ka pranuar ankesë nga KESCO kundër vendimit të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve për konsumatorin Kamber me te cilën ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të pezulloj vendimin e DMK-së duke pranuar kundërtimin e KESCO-s dhe se vlera e borxhit të ngelet konstest deri në përfundimin e procedurave ligjore. KESCO në ankesën e saj ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, dhe në ankesë ka atakuar disa çështje. Në ankesë theksohet se konsumatori në pjesën më të madhe ndër muaj dhe vite ka psur lexim të rregullt dhe se për muajt që lexuar me vlerësim lexuesi nuk ka pasur çasje në pikën matëse. KESCO në ankesë ka theksuar se konsumatori i janë bërë dy korrigjime në vlerë prej -80.28€ duke korrigjuar faturat 12/2013 deri në 05/2014 dhe një korrigjim tjetër prej -31.11 duke korrigjuar faturat 10/2013 deri më 03/2014. Kundërshtim tjetër i KESCO i paraqitur në ankesë është se ekipet e terrenit nuk mund të japin konstatime e as vlerësime ppr gjendjen e njehsorit nga jashtë, por është qendra e kalibrimit kompetente për këtë veprim. KESCO në ankesën e tij po ashtu ka theksuar se konsumatori përveç faturës së lartë të muajit 03/2014 ka edhe fatura të tjera të larta, si ajo e muajit 12/2014, 04/2015. KESCO në fund të ankesës ka theksuar se konsumatori ka theksuar se më shumë jeton në perëndim se sa në Kosovë, por që në periodha të caktuara në objektin e konsumatorit mund të ketë pasur banues tjerë (qeraxhi) të cilët kanë shpenzuar energjinë elektrike.

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 03.04.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën mars 2014 me **11,828 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **1,220.76€**. Pas arritjes së kësaj fature konsumatori me datë 05.05.2014 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë .



Punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori me datë 17.05.2014 kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektirk nr.4581873 me gjendja TL=69864 kWh dhe TU=52783 kWh, dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 63608792 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh, si dhe është theksuar se ndërrimi i njehsorit elektrik bëhet sipas kërkesës së menaxhmentit të KEDS-it.

Prapë punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektim të pikave matëse me datë 16.07.2014 kanë dalur te konsumatori dhe kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit kanë theksuar se në këtë shtëpi nuk jetojnë rregullisht pasi që jetojnë jashtë vendit dhe se në njehsorin e vjetër dyshohet relea kohore dhe ka ardhurderi te fatura shumë e madhe, andaj është kërkuar të korrigjohet gjendja pasi që nuk i është leximi. Në procesverbal punëtorët e KEDS-it kanë evidentuar gjendjen e shpenzimit të njehsorit elektrik nr. 63608792 me gjendje TL=000536 kWh dhe TU=000331 kWh.

Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 18.07.2014 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 11313314 të datës 16.07.2014.

Me datë 14.10.2014 punëtorët e autorizuar të Qendrës së Kalibrimit kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektirk nr. 4581873 dhe kanë theksuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar, njehsori elektrik nuk është i dëmtuar nga ana e jashtme, tarifa e parë dhe e dytë janë në rregull.

I paknaqur me përgjigjen e KEDS-it konsumatori me datë 10.12.2014 ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar faturën e muajit 03/2014. DMK pas kësaj ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe me datë 17.09.2015 ka nxjerrë vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KESCO që: i) anuloi faturën nr. 03140DPR-16683 të datës 03.04.2014 në vlerë **1,220.76€** te shifra e konsumatorit DPR –16683 dhe ii). për muajin 03/2014 të faturon konsumatorin me shifër DPR – 16683 me mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike të vitit 2013 dhe atë prej 1,153.92 kWh apo TL=611.67 kWh dhe TU=542.25 kWh.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e KESCO-s nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se vendimi i DMK-së nuk është i mbështetur në prova dhe në ligj.

Sa i përket kundërshtimit të KESCO-s se në pjesën më të madhe ndër muaj dhe vite konsumatori ka pasur lexim të rregullt, Bordi i ZRRE thekson se gjatë analizës së bërë shpenzimeve të energjisë elektrike dhe transkacioneve të konsumatorit ka vërejtur se prej periudhës 08/2002 e tutje te konsumatori me shifër DPR – 16683 fillimisht kemi lexim dhe faturim në të dy tarifën, pastaj kemi lexim dhe faturim vetëm në tarifën e ulët, pastaj nuk ka fare shpenzim të faturuar, pastaj ka lexim dhe faturim në të dy tarifën, pastaj ka shpenzim të faturuar vetëm në tarifën e lartë, e për të cilën njehsori ka qenë dy tarifor. Bordi i ZRRE thekson se nga analiza e bërë procesverbalit të shpenzimit të energjisë elektrike nr. 057831 të datës 17.05.2014 dhe rrjedhës së energjisë elektrike ka vërejtur se ka mospërputhje e shpenzimit të energjisë elektrike në tarifën e ulët dhe atë në peirudhën 04/2014 dhe 05/2014. Nga analiza e bërë shpenzimit të energjisë elektrike Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se kjo mospërputhje është që nga periudha 10/2013, pasi që nga kjo periudhë gjendja në tarifën e ulët është më e lartë se ajo e evidentuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik. Pra, me këtë Bordi i ZRRE-së thekson se konsumatori me shifër DPR – 16683 nuk ka pasur lexim dhe faturim korrekt, e që me këtë lexim dhe faturim jo korrekt, KESCO ka vepruar në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 3, nënparagrafi 3.6 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji dhe



procedurën e leximit dhe faturimit të konsumatorëve tarifor, pasi KEDS-i dhe KESCO janë të obliguar të sigurojnë lexim dhe faturim të saktë dhe të rregullt të njehsorit elektrik.

Pikë tjetër e kundërshtimit e KESCO-s është se punëtorët e terrenit të KESCO-s nuk mund të japin konstatime e as vlerësime për gjendjen e njehsorit nga jashtë, por është qendra e kalibrimit kompetente për këtë veprim dhe të cilët kanë konstatuar se njehsori elektirik është brenda kufijve të lejuar të matjes. Bordi i ZRRE-së thekson se është e vërtetë se në protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik nr. 10320 të datës 14.10.2014 është konstatuar se njehsori elektirik nr. 4581873 është brenda kufijve të lejuar dhe se njehsori elektrik nuk ka asnjë dëmtim të jashtëm, si dhe është konstatuar se tarifa e lartë dhe e ulët janë në rregull, por që punëtorët e KEDS-it si dhe të qendrës së kalibrimit nuk kanë dhënë asnjë sqarim se si në periudha të caktuara kohore njehsori elektirik nr. 4581873 herë ka matur energji elektrike në të dy tarifën, herë në tarifën e ulët, e herë në tarifën e lartë dhe për këtë nuk ipet asnjë sqarim se a është dëmtuar më parë njehsori tarifor (tarifa e lartë dhe e ulët), a është rregulluar nga punëtorët e autorizuar të OSSH apo njehsori tarifor vetvetiu është çrregulluar dhe vetvetiu është rregulluar. Bordi poashtu thekson se sipas nenit 32 të Ligjit për Energjinë, thuhet se: *“Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmisionit ose Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë”*, dhe sipas nenit 3.5 të Kodit të Matjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) është përgjegjës për mirëmbajtjen e njehsorit elektrik.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit se konsumatori përveç faturës konstestuese 03/2014 ka edhe fatura të tjera të larta si ajo e periudhës 12/2014 dhe 05/2014, Bordi i ZRRE-së thekson se ka mospërputhje të madhe të shpenzimit të faturuar për muajin 03/2014 me shpenzimet e faturuara para dhe pas periudhës konstestuese. Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit nëpër vite dhe për periudhën konstestuese ka vërejtur se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik (kontesues) nr. 4581873 prej periudhës 08/2002 e deri më 05/2014 është 698.29 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin e ri elektrik nr. 63608792 prej periudhës 05/2014 e deri më 08/2015 është 1,012.65 kWh/muaj. Po ashtu Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se shpenzimi i përgjithshëm i energjisë elektrike i vitit 2013 është 13,847 kWh, për vitin 2012 është 7,462 kWh, ndërsa shpenzimi i faturuar vetëm në muajin 03/2014 është 11,828 kWh, pra nga kjo vërehet se a mospërputhje të madhe mes shpenzimeve të energjisë elektrike të fatruara për konsumatorin.

Pikë tjetër e kundërshtimit e KESCO-s është se konsumatori ka theksuar se më shumë jeton në perëndim se sa në Kosovë, por që në periudha të caktuara në objektin e konsumatorit mund të ketë pasur banues tjerë (qeraxhi) të cilët kanë shpenzuar energjinë elektrike. Sa i përket kësaj pike të kundërshtimit. Bordi i ZRRE-së thekson se KESCO nuk ka prezantuar asnjë dëshmi lidhur me këtë se a ka banues tjerë (qeraxhi) në atë objekt, e poashtu edhe konsumatori nuk e ka cekur në ankesën tij drejtuar ZRRE-së, andaj edhe si i të tillë ky kundërshtim nuk është i bazuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1338\_06\_15, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Krenar Bujupi, anëtar

---

Arsim Janova, anëtar

---

Qemajl Mustafa, anëtar

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit K. E., dhe
- Arkivit të ZRRE-së